



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-06d/01-3594 dt. 22/01 2025

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z.Bekim Lestrani, më datë: 31.01.2025 (E premtë) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i dt. 30.12.2024
2. Propozim vendim për ndryshim-plotësimin e rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoha.
3. Propozim vendim për plotësim/ndryshimin e vendimit nr.02-400/01-57008, dt 29.11.2024 për miratimin e Raportit të Komisioneve Komunale përfundimtare për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.
4. Raporti i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2024.
5. Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2024
6. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me aftësi të kufizuara.
7. Të ndryshme.

Drenas, 22.01.2025



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Bekim Lestrani



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-3417 dt. 21.01. 2025

PROCESVERBAL

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 30.12.2024, duke filluar në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani dhe deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 27 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri - Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Kosovare Halilaj- Karaxha (PDK), Sali Dvorani (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK), Sali Dvorani (DD).

Munguan: Florentina Elezi (LVV), Blerina Gashi (PDK), Kosovare Halilaj- Karaxha (PDK), Zeqir Hasi (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Kryetar i Komunës Ramiz Lladrovci, Arben Shala nënkryetar i Komunës, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues nga Zyra e informimit.

Prezent ishin 27 anëtarë të Kuvendit Komunal.

Mbledhja do të ketë këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 29.11.2024;
2. Plani i Punës i Kuvendit Komunal për vitin 2025;
3. Plani i punës i Kryetarit të Komunës së Drenasit për vitin 2025;
4. Plani i punës për vitin 2025 i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
5. Plani i veprimtë për transparencë komunale;
6. Rregullore për transparencë komunale;
7. Lista e rreziqeve komunale për vitin 2025;
8. Raport i vlerësimit të rreziqeve për Komunën e Drenasit gjatë vitit 2024;
9. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Drenasit për vitin 2024;
10. Informim i punës në Kuvendin Komunal për aktivitetet e Këshillit për Siguri në Bashkësi nga kryesuesi i KKS-së, për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024;
11. Propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 35 vjet, pronën e paluajtshme të Komunës, me procedurë të negociimit të ofertës së kompanisë "TDI Balkans", parcelat

- me nr. P-70310053-00539-0, zona kadastrale Negroc, P-70315035-00848-0, zona kadastrale Krajkovë, P-70315035-00913-0 Krajkovë;
12. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vjet, pronën e paluajjtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës, personit fizik-juridik "Nika Enterier LLC-Gllogoc", të cilën e përfaqëson Bashkim Nika, parcelën me nr. P-70314035-00004-124, zona kadastrale Komoran;
 13. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vjet, pronën e paluajjtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës, personit fizik Musa Binaku, me nr:1170456510, parcelën me nr. 70314035-01981-0, zona kadastrale Komoran;
 14. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vjet, pronën e paluajjtshme të Komunës, me procedurë të negocimit të ofertës, personit fizik-juridik "BP Plastik SH.P.K", të cilën e përfaqëson Ermal Bunjaku, parcela me nr. P-70314016-00034-0 zona kadastrale Korroticë e Epërme;
 15. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, përshëndetje për të gjithë, fjalën e merr Kryetari.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, unë propozoi që këto pika me u terhjekë për dhënien e pronës në shfrytëzim me negocim për shkak të afateve të kohës, sepse jemi vetëm dy ditë para vitit të ri 2025 dhe këto do t'i sjellim në janar të vitit 2025. Dhe kam me shtuar një pikë të rendit të ditës, Propozim-vendim për shfuqizimin e komisionit i cili ka pasur të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarin e Komunës në lidhje me vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënien e pronave me negocim.

Kërkojë nga ju me e shfuqizuar këtë vendim, vetëm për një arsye neve mundet me na penalizu Ministria vitin e ardhshëm për grant të performancës për mos shfuqizim të dokumenteve, sepse për të njëjtin vendim në vitin e kaluar ka thënë që nuk i nënshtrohet ligjshmërisë këtë vite ka thënë që i nënshtrohet d.m.th është në kundërshtim më ligjin, ndërsa nuk e kanë cek me çfarë ligji, mirëpo ne do të shkojmë në proceduara administrative në gjykatë.

Egzona Terdevci, po me vjen mirë që po tërhiqen pronat, sepse edhe ashtu nuk i kanë plotësuar kriteret për të Ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës publike pronat që jepen më negocim njëra prej kriterëve është se në rastin kur një investitor ka shprehur interesim për hapjen e biznesit në këtë rast e Komunës është disa janë në interes disa jo, po pika kryesore që bie në kundërshtim me pronat që i keni sjell ju është në rastin kur nuk ka interesim për marrjen e pronës së Komunës në shfrytëzim nga palët për së paku tri vitet e fundit.

Përveç për pronën që kërkohet prej "TDI Ballakns", për tri pronat tjera ka pasur interesim në vitin 2022 në seancën e datës 24.11.2022, kanë qenë në rënd të ditës edhe parcela 9810 në Komoran dhe 124 është kërkuar me herët, parcela 340 në Korroticë të Epërme është kërkuar me herët po edhe propozim-vendimin kur e keni bërë jeni thirrur në rregulloren e gabuar, sepse rregullorja që merret me çështjen e pronave nuk është (6) gjashtë 2020, por është (9) nëntë 2020, pra nuk i keni plotësuar kushtet, sa për vendimin për komision ju vet në fund të vendimit e keni lënë që ky vendim i nënshtrohet ligjshmërisë të MAPL-së, pritet 15 ditë për përgjigje.

Qysh është ai shablloni zyrtar nuk është kthyer komisioni pse është bërë me i ndihmuar Kryetarit për negocim po është kthyer pse kur është kthyer ligjshmëria e pronave me dt. 22.11.2024 ka

qenë shumë e qartë së për shkak së është një situatë e pa precedent asnjëherë nuk kanë kaluar aq shumë prona.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim rendin e ditës me pikën shtesë, **Propozim-vendim për shfuqizimin e Komisionit i cili ka pasur të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarin e Komunës në lidhje me vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënien e pronave me negocim dhe rendi i ditës kaloi me vota unanime.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit më 29.11.2024, pasi nuk pati vërejtje as diskutime pika e parë e rendit të ditës kalon më vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 2. Plani i Punës i Kuvendit Komunal për vitin 2025.

Egzona Terdevci, faleminderit kryesues e kam një vërejtje që e kam përsërit edhe më herët ne zakonisht e lëmë në plan të punës muajin gusht pushim, por prej kur jemi në këtë mandat të asamblesë çdo herë kemi mbajtur seanca në muajin gusht. Nuk është e arsyeshme me lënë pushim kur ne në realitet gjithë mbajmë seanca gjatë muajit gusht, propozoi që dita e seancave me qenë një ditë e caktuar p.sh e ënjta e fundit e muajit, me pas një ditë të njëjtë çdoherë, po ashtu e kem folur edhe në vitin e kaluar kur e kemi bërë Planin e punës të Kuvendit Komunal, Plani i prokurimit të jetë parë të ndahet me Kuvendin dhe një vërejtje që na është përcjell sidomos nga njerëzit që vijnë nga fusha e artit dhe e kulturës. Subvencionet me i parashikuar me herët në muajin mars, jo me u përsërit situata e njëjtë që kanë mbet pa u ndarë subvencionet për shkak së mjetet janë tërheq prej thesarit.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, çështjet e ekzekutivit i vendosi unë jo dikush tjetër, Kuvendi e ka për detyrë me i votuar apo mos me i votuar. Sa i përket mbledhjeve unë e falënderoj kryesuesin dhe pjesëmarrësit që kanë marrë pjesë në punimet e Planit të punës, me vjen keq që edhe nuk vini në takime edhe bëni debate në ditën e fundit.

Egzona Terdevci, ne jemi asamblist, pra këtu na vijnë propozim-vendime, nuk janë vendime të prera dhe derisa të votohen ne mundemi me bërë propozime nuk kam asgjë kundër ligjit as rregullores.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Qeverija jote na ka tërheq mjetet me qëllim me ndalë subvencionimin e të gjitha drejtorive që i kemi pas në veçanti të DKRS-së, me vjen shumë keq që njerëzit e artit kulturës dhe sportit që nuk kanë mundur me përfituar nga subvencionet, prandaj atë e vendosi unë t'i nëse ke diçka me i thënë Qeverisë i thua sikurse e kemi votuar buxhetin për të hyra vetanake 60 ditë nuk e kanë kthyer ligjshmërinë për të hyrat vetanaka vetëm për me na nxjerr keq në investime kapitale.

Labinot Halilaj, shumë mirë është me pasur debat sa i përket Planit të punës, mirëpo me thënë që e ënjta e fundit jo gushti mos të mbahet mbledhje çfarë debati është ky ne nuk jemi parti e kuqe komuniste me i vendos ato vijat që veç të enjten me u mbajt mbledhje në ora 10 fiks me ardhur edhe ska. Vazhdojmë me diskutimin nëse ka debate me përmbajtjesorë.

Egzona Terdevci dhe Filloreta Bujupi, lëshuan seancën në ora 10:40.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, ne kemi organizuar punëtori tre ditore edhe i kemi ftuar të gjithë sektorët e ekzekutivit që gjatë përpilimit të Planit të punës së Kuvendit, anëtarët e Kuvendit që kanë propozime për me i futë pikat e caktuara me pas të çartë çka lejohet e çka nuk lejohet me ligj, për ndryshe jemi në rregull sa i përket debatit për Planin e punës së Kuvendit.

Hamit Haxhiu, unë po besoi që për tri ditë që ka qenë punëtorja që është organizuar prej Kuvendit ata që kanë dëshiruar me dhënë kontribut për ata është organizuar ajo tryezë aty dhe mendoi së është shterrë dhe këtu është vetëm për votim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën 2. Plani i Punës i Kuvendit Komunal për vitin 2025. **Kryesuesi konstatoi se me vota unanime kalon pika e dytë e rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 3. Plani i punës i Kryetarit të Komunës së Drenasit për vitin 2025. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani**, hodhi në votim pikën tre me **22 vota "Për", Kundër "0", Abstenim "1"**, kaloi edhe pika e tret e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 4. Plani i punës për vitin 2025, i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani**, hodhi në votim pikën 4. Plani i punës për vitin 2025 i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, me **22 vota "Për", Kundër "0", Abstenim "0"**, kaloi pika e katër e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 5. Plani i veprimit për transparencë komunale. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani** hodhi në votim pikën e pestë, me **23 vota "Për", Kundër "0", Abstenim "0"**, kaloi pika e pestë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 6. Rregullore për transparencë komunale. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime. **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani** hodhi në votim pikën e gjashtë dhe kaloi në vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 7. Lista e rreziqeve komunale për vitin 2025. **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani** hodhi në votim pikën e shtatë, me **24 vota "Për", Kundër "0", Abstenim "0"**, kaloi pika e shtatë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 8. Raport i vlerësimit të rreziqeve për Komunën e Drenasit gjatë vitit 2024. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime. **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani** hodhi në votim pikën e tetë me **23 vota "Për", Kundër "0", Abstenim "0"**, kaloi pika e tetë e rendit të ditës.


Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 9. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Drenasit për vitin 2024. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime. **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani**, hodhi në votim pikën e nëntë me **23 vota "Për", Kundër "0", Abstenim "0"**, kaloi pika e nëntë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën **10**. Informim i punës në Kuvendin Komunal për aktivitetet e Këshillit për Siguri në Bashkësi nga kryesuesi i KKSBS-së për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024, pasi është vetëm informim nuk ka nevojë të votohet.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e **11**. Propozim - vendim për shfuqizimin e Komisionit i cili ka pasur të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarin e Komunës në lidhje me vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie e pronave me negociim. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime. **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani**, hodhi në votim pikën e njëmbëdhjetë, **me 22 vota” Për”, Kundër ”1“, Abstenim ”1”, kaloi pika e njëmbëdhjetë e rëndit të ditës.**

Mbledhja përfundoi në ora **11:20**.


Procesmbajtëse:



Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Bekim Lestrani



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



01 Nr 400/01-3385 dt. 21.01.2025

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gaz. Zyrt. e Republikës së Kosovës”), Dispozitive të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049 si dhe në bazë të Ligjit Nr. 08/L-257 (Për Administrimin e Procedurave Tatimore) neni 5 pika 6 dhe dispozitat tjera si dhe LIGJIT NR. 08/L-262 Kapitulli XXIV Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datën 27.07.2023 të aprovoj:

PROPOZIM VENDIM
PËR NDRYSHIM-PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA, TARIFA,
NGARKESA DHE GJOBA

Neni 1

Me këtë Vendim, miratohet Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 12 Nr.400/03-62198 të dt. 28.12.2023.

Neni 2

Ndryshohet Neni – Pika - **13.1.1** Bizneset do të ngarkohen sipas kodit primar të ushtrimit të veprimtarisë.

Ndryshohet Neni – Pika - **13.2.2** Bizneset ekzituuese dhe ato fillestare që ushtrojnë veprimtaritë e tyre nga sektori A lirohen nga taksa në afatë të pacaktuar, përjashtimisht kodeve të parapara në ngarkesë.

Ndryshohet Neni – Pika - **13.2.4** Bizneset të cilat nuk janë duke ushtruar veprimtarine lirohen nga taksa bazuar në regjistrin e veqantë të tatimpaguesëve joaktiv (pasive) të derguar nga ATK/ARK. Regjistri i siguruar do të zbatohet për bizneset të silet nuk kanë qenë aktive nuk kanë ushtruar veprimtarinë gjatë vitit 2024 e tutje.

Ndryshohet: Neni – Pika - **13.2.6** Drejtoria për Zhvillim Ekonomik faturimin do ta bëjë deri më 30 shtator të vitit fiskal.

Ndryshohet: Neni – Pika - **13.2.7** Subjektet ekonomike faturën e caktuar sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje do ta paguajnë në afatin prej 30 ditësh nga data e pranimit në të kundërtën lënda do të procedohet për inkasim të detyrueshëm përmes inicimit të procedurës përmbarimore.

Ndryshohet: Neni – Pika - **13.2.8** Subjektet ekonomike faturën e pranuar brenda 30 ditësh mund ta kontestojnë me anë të ankesës Drejtuar Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik.

Hiqet: Neni – Pika **13.2.9.**

Ndryshohet: Neni – Pika - **13.2.11** Në raste që bizneset nuk marrin faturat, ato janë të obliguara te interesohen për obligimet e tyre ndaj komunës, pra ta vizitojnë zyrën e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik pranë Komunës së Drenasit. .

Shtohet: Bizneset të cilat ushtrojnë veprimtarinë ngarkohen me këto vlera: Kodet: 1106 me vlerë 1,000.00 €, 4673 me vlerë 300.00 €, 5812 me vlerë 50.00 €, 6010 me vlerë 150.00 €, 7734 me vlerë 150.00 €, 7735 me vlerë 150.00 €.

Neni 3

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.


Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-257 (Për Administrimin e Procedurave Tatimore) , Nr. 08/L-257 (Për Administrimin e Procedurave Tatimore) neni 5 pika 6 dhe dispozitat tjera si dhe LIGJIT NR. 08/L-262 Kapitulli XXIV Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe rregullimin e procedurave rreth aplikimit të nenit 13 të

rregullores, kërkohet nga ana e kryetarit të komunës që të bëjë plotësim Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 12 Nr.400/03-62198 të dt. 28.12.2023.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e kryetarit



01 Nr 400/01-2555 dt. 15/01/2025
NR. 108

Në veshtrim të nenit 58, paragrafi 1, nenparagrafi h, të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 72, të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i komunës së Drenasit, propozon që në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1, 12.2 pika d dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit Nr.04-L-027 për mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera si dhe Rregullores (QRK) Nr.17.2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë, _____ 2025 të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për plotsim/ndryshimin e vendimit nr.02-400/01-57008, dt.29.11.2024 për miratimin e Raportit të Komisioneve Komunale përfundimtarë për vlerësimin e Dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera

Neni 1

Me këtë vendim në përputhje me nenin 31, paragrafi 1.1, të Rregullores (QRK) Nr.17.2015, për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, propozohet miratimi i Raportit të Komisioneve Komunale përfundimtarë për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera .

Neni 2

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi miratohet vlerësimi i dëmeve nga bresheri në bujqësi dhe ne ekonomi familjare ne shumën totale prej **215,304,87 €**.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente.

Neni 4

Ky propozim vendim hynë në fuqi pas aprovimit nga ana e kryetarit të komunës dhe verifikimit nga ana e komisionit qendror për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësit e tjera



Kryetari Komunës


Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Ky propozim/ndryshim bëhet për arsye se gjatë ndarjes së dëmeve nga bresheri të shkaktuara në bujqësi dhe në ekonomi familjare siç edhe është kërkuar nga Menaxhimi i Emergjencave në Prishtinë, ne si komisione gjatë punës kemi hasur se kemi një gabim teknik të vlerës totale në vendimin e miratuar 02Nr.400/01-57008 të datës 29.11.2024 me raportet përfundimtare të komisioneve sipas vendimeve të miratuara, andaj kërkojmë të bëhet ky ndryshim në vlerën përfundimtare në vendim sipas raporteve.

Raporti i Komisionit Komunal përfundimtarë për vlerësimin e dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera është një dokument i hartuar në përputhje me ligjin Nr.04/-L-027 për mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera dhe Rregulloren (QRK) Nr.17.2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera e cila i obligon komunat që të themelojnë komisionet për vlerësimin e këtyre dëmeve përmes së cilit është bërë vlerësimi i tyre me qëllim të përcaktimit të llojit dhe madhësisë së dëmit në të mira materiale e shprehur në vlerë monetare të nevojshme për kthimin e të mirave materiale të dëmtuara apo shkatërruara në gjendjen e tyre paraprake, përkatësisht në vlerën e cila është e nevojshme që këto të mira materiale të blihen apo riparohen.

Një dokument i tillë u drejtohet me propozimin për miratimin e tij duke marrë parasysh faktin se sipas legjislacionit në fuqi Kryetari i Komunës obligohet që së bashku me mendimin e tij të njëjtin ta dorëzoj në kuvendin komunal për shqyrtim dhe miratim ku edhe pas miratimit i njëjti në afatin prej 15 ditëve dorëzohet tek Agjencia e Menaxhimit Emergjent dhe një kopje Komisionit Qendrorë të vlerësimit të dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera i cili më pastaj konstaton për korrektësinë apo për mangësitë eventuale të tij .

Andaj duke pasur parasysh këtë si dhe rekomandimet e Komisionit Qendrorë të vlerësimit të dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera lidhur me procedurën e shqyrtimit të raporteve të komunave për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mirat materiale dhe ndikimi i fatkeqësive tjera propozon që brenda afatit ligjorë dhe në përputhje me nenin 31 paragrafi 1.1 I rregullore (QRK) Nr.17.2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera të miratoj këtë propozim vendim .



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Komuna/Opstina/Municipality Drenas (Glllogoc)
Zyra e Kryetarit

01 Nr. 400/01-3482 Dt. 22/01/2025



RAPORTI FINANCIAR JANAR - DHJETOR 2024

JANAR 2025

1. Hyrje

Raporti financiar buxhetor, për periudhën janar – dhjetor 2024, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët: 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit, nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Raporti i përgatitur nga Kryetari i Komunës, mbulon periudhë janar – dhjetor të vitit fiskal 2024 dhe paraqet informatën e përcaktuar, që ka të bëjë me arkëtimin, shpenzimet dhe të dhënat mbi investimet.

1.1. Performanca e të hyrave

Grumbullimi i të hyrave buxhetore ka vazhduar gjatë këtij viti. Të hyrat tatimore dhe jotatimore kanë shënuar një rritje nga 1,560,705.00 € sa ishte planifikimi, në 3,746,116.07 €. Për shkak të vendimit të Kuvendit të Komunës për falje të borgjit të tatimpaguesve deri në 100€, të hyrat tatimore kanë pësuar rënie dhe grumbullimi më i madh i të hyrave ka vazhduar me të hyra jotatimore. Granti i performancës përfshin vlerën prej 1,118,447.72€, gjjobat e gjykatave 103,130.71€ si dhe gjjobat e komunikacionit 822,935.00€.

1.2. Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore për këtë periudhë kanë arritur vlerën prej: 23,274,982.67 € përgjatë tërë vitit 2024, apo 94.06 % të buxhetit të komunës për vitin 2024. Ky shpenzim kryesisht është i ndikuar nga ekzekutimi më i lartë i shpenzimeve nga kategoria e pagave dhe mëditje si dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore përmbarimore të cilat derivojnë nga Kontrata Kolektive.

Shpenzimet për **paga dhe shitesa** gjatë këtij viti, shënuan vlerën prej 11,852,007.60 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 98.20% krahasuar me vlerën e përgjithshme të alokuar për këtë kategori. Nga vlera e përgjithshme e ekzekutuar në këtë kategori të shpenzimeve, shuma prej 1,092,665.14€ është shpenzuar për vendime gjyqësore.

Shpenzimet në kategorinë ekonomike- **mallëra dhe shërbime**: Gjatë kësaj periudhe vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur shumën prej: 2,504,290.44 € apo 90.86 % të buxhetit të planifikuar për këtë kategori prej ku 355,283.05 € janë ekzekutuar për vendime gjyqësore.

Shpenzimet në kategorinë ekonomike- **Komunali**, kanë arrit shumën prej: 334,769.66€ apo 95.37% të buxhetit të planifikuar. Për vendime gjyqësore/ përmbarimore janë ekzekutuar 27,849.16 €.

Shpenzimet për kategorinë ekonomike- **subvencione dhe transfere**, shënuan vlerën prej: 502,991.54 € gjatë kësaj periudhe, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 98.92 % krahasuar me vlerën e përgjithshme të alokimit të buxhetit të kësaj kategorie për këtë vit. Nga vlera e përgjithshme e ekzekutimit, 221,873.92€ janë ekzekutuar për vendime gjyqësore.

Investimet kapitale arritën vlerën e realizimit prej: 8,079,423.43€, që është 87.10 % e buxhetit të alokuar për vitin 2024. Krahasuar me shpenzimet në këtë kategori gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2023 kemi rritje të shumës së shpenzuar për: 586,181.86 €.prej nga vlera prej 1,879,133.20€ është ekzekutuar për vendime gjyqësore.

Të hyrat vetanake janar- dhjetor 2024 dhe krahasimi me vitet paraprake

Përshkrimi	2022	2023	2024	% me 2023
	në Euro			
1. GJITHSEJ TË HYRA	2,857,555.09	4,145,840.80	3,746,176.71	90.36
1.1. Të hyrat nga kodi 16301	123,090.82	128,506.13	125,358.06	97.55
Te hyrat në pritje per shperndarje				
Taksa për certifikata (50013-50016)	49,192.09	52,833.00	49,987.45	94.61
Taksa per verifikimin e dokumenteve te ndryshme(50017)			4,343.18	-
Vert.Fotok.dokumentacionit (50018)	642.5	676.5	891.00	131.71
Kerkesat 50019	7,087.78	6,716.63	5,210.49	77.58
Kthimi I takses nga gjykata 50022			988.22	-
Gjobat tjera 50107			268.33	-
Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare 50407	66,120.45	68,280.00	61,390.34	-
Të Tjera 50413	48			-
Polica e sigurimit 50450			1,875.00	-
Te hyra tjera 50424			404.05	-
1.2.Të hyrat nga kodi 16601	5,485.00	17,113.90	28,114.10	164.28
Gjobat e tjera 50107			111.00	-
Të hyra nga Inspeksioni 50104	5,485.00	17,113.90	28,003.10	163.63
1.3.Të hyrat nga kodi 17501	791,131.24	1,053,855.17	528,237.32	50.12
Tatimi në pronë 40110	674,100.24	927,166.17	383,330.32	41.34
Tax për regjistrimin e automjetit 50001	117,031.00	126,689.00	144,907.00	114.38
1.4. Të hyrat nga kodi 18001	7,085.00	20,070.51	3,764.84	18.76
Tax për parki.nga Sh.Publike 50008	7,085.00	12,897.00	2,240.50	17.37
Taksa per leje ndertimi 50009			677.00	-
Taksa te tjera administrative 50019			2.00	-
Te hyrat nga viti I kaluar 61000			845.34	-
Tax për treg të hapur-kafsheve 50406		7,173.51		0
1.5. Te hyrat nga kodi 47001	-	332.00	-	-

Taksë nga pylltaria 50107	-	332.00	-	-
1.6. Te hyrat na kodi 48001	196,235.00	270,682.90	231,870.90	85.66
Gjobat e tjera 50107			103.00	-
Licenca per aktivitete individuale dhe profesionale 50201	196,235.00	270,682.90	231,767.90	85.62
1.7. Të hyrat nga kodi 65005	71,998.50	103,565.00	80,022.00	77.27
Tax regjistrim prone 50011	52,492.00	83,977.50	66,876.00	79.64
Tax fletposeduese kopje planit. 50032	19,457.50	19,450.00	11,993.00	61.66
Matje gjeodezike 50504	49.00	137.50	1,153.00	838.55
1.8. Të hyrat nga kodi 66310	249,078.42	313,263.53	615,949.06	196.62
Taksa per parkim publik, kamping dhe rekreacion 50008			94.00	-
Taks per leje ndertimi 50009	222,686.25	215,304.93	546,426.81	253.79
Shfrytzimi I pronës Komunale 50405	3,159.32	11,491.17	24,729.73	215.21
Tax per ndrrim te destinimit te tokës 50012	22,707.85	60,614.77	26,251.60	43.31
Tax për legalizim te objekteve 50026	525	25,852.66	10,886.52	42.11
Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare 50407	-	-	839.40	-
Shitja e pasurise publike 50413	-	-	6,721.00	-
1.9. Të hyrat nga kodi 73100	35,861.00	39,869.00	45,937.50	115.22
Participimi shendetësi	35,861.00	39,869.00	45,937.50	115.22
2.0. Te hyrat nga kodi 85001	210	1994.72	179.5	9.00
Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare 50407	-	-	30	-
Qiraja nga prona publike	210	1994.72	149.5	7.49
2.1. Te hyrat nga kodi 92210	26,063.20	33,740.00	42,230.00	125.16
Participimi Arsimi	26,063.20	33,740.00	42,230.00	125.16
2.1 Të Hyrat Indirekte	1,351,316.91	2,162,847.94	2,044,513.43	94.53
Gjobat e gjykatave	51,325.45	43,117.50	103,130.71	239.19
Gjobat e komunikacionit	795,133.50	600,106.50	822,935.00	137.13
1.7.3 Donacion / Granti i Performances	504,857.96	1,519,623.94	1,118,447.72	73.60

Shpenzimet për periudhën janar– dhjetor 2024 dhe krahasimi me vitet paraprake

Përshkrimi	2022	2023	2024	Buxheti për vitin 2024	% e shpenzimit
Vitet	2	3	3	4	Me vitin 2023
2. GJITHSEJ SHPENZIMI	17,510,949.53	21,610,658.39	23,273,482.67	24,743,446.42	107.70
Shpenzimet operative	12,091,255.50	13,658,532.82	14,691,067.70	14,959,382.10	107.56
2.1.1 Paga dhe mëditje	9,672,207.55	10,909,740.14	11,852,007.60	11,852,273.86	108.64
2.1.2. Mallra dhe shërbime	2,143,765.30	2,433,413.90	2,504,290.44	2,756,111.69	102.91
2.1.3 Shpenzime komunale	275,282.65	315,378.78	334,769.66	350,996.55	106.15
2.2 Subvencione dhe transfere	413,003.69	458,884.00	502,991.54	508,439.31	109.94
2.3 Shpenzime kapitale	5,006,690.34	7,493,241.57	8,079,423.43	9,275,625.01	107.82
2.3.1 Rezervat	-	-			

Subvencionet Janar- Dhjetor 2024 dhe krahasimi me vitet parapake

Përshkrimi	2022	2023	2024	% me
	Shumat në Euro			2023
Zyra e kryetarit	10,700.00	6,436.20	7,200.00	93.22
DSHPE	126,050.00	82,750.96	73,035.00	84.46
D.Bujqësisë	41,603.30	50,000.00	33,000.00	60.00
D.Zhvillimit ekonomik	-	23,000.00	25,189.62	80.43
D.Kulturës, Rinisë dhe Sportit	102,750.00	127,796.63	105,577.00	82.16
Drejtoria e Shëndetësisë	15,000.00	24,170.00	115,482.00	477.79
Drejtoria e Arsimit	84,000.00	98,849.90	143,507.92	144.67
Gjithsej	380,103.30	413,003.69	502,991.54	118.13

Shpenzimet në projekte kapitale për periudhën janar–dhjetor 2024

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri me TM4/2024	Mbetja	Progresi i TM4 /2024 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
18001	DSHPE				
53316	Sinjalizimi Horizontal dhe vertikal I rrugëve vendbanimeve	50,000.00	47,196.00	2,804.00	94.39
53330	Rreg.dhe rrethimi I varrezave Drenas dhe Komoran	23,656.00	23,094.24	561.76	97.63
53341	Zgjerimi i kamerave Drenas dhe Komoran	10,000.00	6,181.75	3,818.25	61.82
53346	Rregullimi I trotuarve dhe parkingjeve Drenas dhe Komoran	10,000.00	9,972.00	28.00	99.72

53364	Rregullimi dhe zgjerimi I vendndaljev dhe mbulimi I tyre	20,233.50	0	20,233.50	0
50515	Rregullimi I sistemit te ujitjes per parkun e qytetit	50,000.00	50,000.00	0.00	100
	GJITHSEJ	163,889.50	136,443.99	27,445.51	83.25

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-3/2024	Mbetja	Progresi i TM3 /2024 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
18161	Drejtoria e Infrastruktures Publike				
48254	Rregullimi I shtratit të lumit Drenica dhe Verbica	25,000.00	24,999.99	0.01	100
48632	Asfaltimi I rrugës Gllanasellë, Godanc	100,000.00	100,000.00	0.00	100
48635	Asfaltimi I rrugës Paklek I vjeter, I Ri, Vasilevë	140,327.28	131,199.38	9,127.90	93.50
48638	Asfaltimi I rrugës Dobroshec, Çikatovë e vjeter	115,000.00	108,028.89	6,971.11	93.94
48643	Asfaltimi i rruges ne fshatrat Gradicë dhe Likoshan	80,000.00	23,157.00	56,843.00	28.95
48646	Asfaltimi rruges Arllat Negroc Gjergjic Bytyq	80,000.00	24,165.00	55,835.00	30.21
48648	Asfaltimi I rruges Sankoc Fushticë	80,000.00	79,999.99	0.01	100
48653	Asfaltimi I rruges Shtuticë, Verboc, Polluzhë	80,000.00	80,000.00	0.00	100
48656	Asfaltimi I rruges Llapushnik, Poterk Vukoc	100,000.00	100,000.00	0.00	100
48658	Asfaltimi I rruges Z.ulet, Lartë K. e ulet dhe e lartë	80,000.00	80,000.00	0.00	100
48661	Ndertimi I kapaciteteve të ujës-jellësit Drenas	648,697.78	554,595.09	94,102.69	85.49
48682	Bashkfinancim projektesh me donator te jashtem	30,000.00	30,000.00	0.00	100
49297	Zgjerimi dhe ndertimi I sheshit Fehmi e Xheve Lladrovci	700,865.99	699,983.24	882.75	99.87
49299	Asfaltimi I rruges Llapushnik Berishë	300,000.00	299,999.77	0.23	100
51323	Kanalizimi I ujerave te zeza Shtutice, Verboc dhe Polluzhe	10	0	10	-
51324	Asfaltimi I rrugve Tersteniku I, II dhe Gilobar	80,000.00	74,144.55	5,855.45	92.68
51340	Asfaltimi I rruges Baicë Krajkovë Damanek Shtrubullovë	100,000.00	100,000.00	0.00	100

52309	Ndërtimi I Rrugës Bregut te Çiqavicës	5,000.00	5,000.00	0.00	100
52310	Ndërtimi I parkut dhe shtigjet për Këmbësor	318,954.00	312,193.38	6,760.62	97.88
53631	Ndërtimi I Kolektorve për grumbullimin e ujërave te zeza	400,000.00	400,000.00	0.00	100
53635	Rregullimi I Trotuarve dhe ndriqimit Publik	449,999.97	403,273.93	46,726.04	89.62
53645	Asfaltimi I rrugëve dhe Kubzimi Drenas I,II,III,IV	435,455.54	405,004.52	30,451.02	93.01
53652	Asfaltimi I rrugëve Komorani I,II,III,IV	100,000.00	99,999.13	0.87	100
53659	Ndërtimi I Tombinave dhe mureve mbrojtëse	80,000.00	48,952.72	31,047.28	61.19
53660	Ndërtimi zgjerimi dhe rikonstruimi I rrugëve të asfaltuara	876,868.86	802,348.85	74,520.01	91.50
53666	Ndërtimi, zgjerimi i rrjetit të kanalizimit	500,000.00	363,339.67	136,660.33	72.67
53670	Asfaltimi I rrugëve Abri dhe Tërdec	80,000.00	79,999.19	0.81	100
53672	Asfaltimi i rrugëve Nekoc Kizhnarekë	80,000.00	77,805.28	2,194.72	97.26
53674	Hapja e kanaleve Kulluese gjatë rrugëve Drenas Komoran	75,000.00	75,000.00	0.00	100
54100	Ndërtimi I rrugëve fushore ne Komunën e Drenasit	50,000.00	50,000.00	0.00	100
54104	Ndërtimi I rruges tranzit Drenas-Kroi I Mbretit	505,000.00	265,006.28	239,993.72	52.48
54108	Ndërtimi I digës për ujëmbledhës në fshatin Verboc	5,000.00	-	5,000.00	-
54266	Rregullimi I inf.ne parkun e pishave ne Komoran- Fushticë	5,000.00	4,357.20	642.80	87.14
92159	Granti për performance komunale	1,118,447.72	1,118,383.05	4.03	100
		7,824,627.19	7,020,936.10	803,691.09	89.73

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM3/2024	Mbetja	Progresi i TM3/2024 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
47001	Bujqësia				
	Grant I donatorve te brendshem	2,213.32	-	2,213.32	-
	Gjithsejt	2,213.32	-	2,213.32	-

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM3/2024	Mbetja	Progresi i TM3/2024 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
66310	Urbanizmi 66310				
53736	Vendosja e sistemit te adresave	7,493.62	6,724.46	769.16	89.74
53737	Gjelbrimi I hapsirave Publike	43,011.80	41,758.82	1,252.98	97.09
54143	Ndërtimi I këndit të lojërave Drenas- Çikatovë e re banimi social	10,000.00	10,000.00	0.00	100
	GJITHSEJ	60,505.42	58,483.28	2,022.14	96.66

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM3 /2024	Mbetja	Progresi i TM3 /2024 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
75501	QPS				
54135	Veturë zyrtare për stafin e qendrës për Punë Sociale	60,000.00	-	60,000.00	-
54131	Ndërtimi shtëpisë për komunitete- Shërbime komunale për persona me aftësi të kufizuara	230,000.00	99,801.64	130,198.36	43.39
	Gjithsej	290,000.00	99,801.64	190,198.36	34.41

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM3 /2024	Mbetja	Progresi i TM3 /2024 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
73100	Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor 73100				
53709	Rrethoja në QMF,AMF Komoran,Arllat, Nekoc, Terdec, Dobroshec	50,000.00	49,731.00	269.00	99.46
49181	Paisje speciale mjeksore mbi 1000 €	30,822.00	-	30,822.00	-
54199	Renovimi I AMF Dobroshec, Sankoc dhe Komoran	30,000.00	-	30,000.00	-
54201	Veturë për vizita shtëpiake	40,000.00	40,000.00	-	-

54203	Blerja e gjeneratorëve për AMF Tërstenik, Gllanasellë, Arllat, Baicë, Nekoc	20,000.00	19,890.00	110.00	-
Gjithsej		170,822.00	109,621.00	61,201.00	64.17

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM3 /2024	Mbetja	Progresi i TM3 /2024 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
85001	Drejtoria e Kulturës 85001				
54014	Fushat sportive dhe rekreacion Arllat, Llapushnik	73,094.59	61,709.00	11,384.76	84.42
54192	Renovimi I objekteve sportive stadioni sintetik Drenas- Komoran	20,000.00	20,000.00	-	100.00
89114	Ndërtimi I Stadiumit Faza e Dytë	270,000.00	219,998.60	50,001.40	81.48
Gjithsej		363,094.59	301,707.60	61,386.99	83.09

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-3/2024	Mbetja	Progresi i TM-3/2024 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
93000	Arsimi Fillor				
49194	Furnizimi I shkollave me pajisje te TIK-ut	70,000.00	67,511.82	2,488.18	96.45
53684	Dixhitalizimi I shkollave softwer, F,Lladrovci	60,000.00	60,000.00	-	100
53687	Kabineti në SHFMU D.Drenicës, SHMP F.Lladrovci , D.Fortesës , SH.Polluzha, M.S. Bytyqi	70,223.00	70,223.00	-	100
53689	Ndërtimi I Parkingjeve dhe Pllatove SH.Galica,G.Syla,7.Marsi	40,000.00	39,448.18	551.82	98.62
53691	Ndërtimi I fushave te jashtme dhe rrethojave G.Elshani, Xh.Lladrovci dhe D.Drenices	50,249.99	8,920.62	41,329.37	17.75

53696	Kendi per Lojra dhe rekreacion Z.Hajdini,QAP Ardhmeria ,R.Kiqina	40,000.00	39,998.00	2.00	100
54207	Ndertimi I aneksit te ri ne SHFMU Rilindja ne Dobroshec	30,000.00	26,978.20	3,021.80	89.93
54209	Instalimi I nxemjeve qendrore- riparimi I kulmit ne SHFMU Xh.Gashi- Plaku Komoran	15,000.00	14,410.00	590.00	96.07
54212	Ndertimi I SHFMU Rasim Kiqina Drenas paralele e ndare ne Shtrubullove	25,000.00	24,940.00	60.00	99.76
GJITHSEJ		400,472.99	352,429.82	48,043.17	88.00

611	GJITHSEJ KAPITALE	9,275,625.01	8,079,423.43	1,196,201.58	87.10
-----	--------------------------	---------------------	---------------------	---------------------	--------------



Ramiz Lladrovci

Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	19/12/2024		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
02	052/01	60095	



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Gllogocit)



Kuvendi Komunal

**KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË
KOMUNËN E DRENASIT**

Publikon:

RAPORTIN VJETOR

Për periudhën:

Janar- Dhjetor 2024

Drenas, 2024

PËRMBAJTJA

I PJESA HYRËSE	4
Plani vjetor i punës së Komitetit Kosultativ PAK për vitin 2024.....	6
II PJESA TEMATIKE	8
Mbledhjet e realizuara dhe aktivitetet e rëndësishme	8
Mbledhja e parë.....	9
Mbledhja e dytë.....	10
Mbledhja e tretë.....	11
Mbledhja e katër.....	13
Mbledhja e pestë.....	15
Mbledhja e gjashtë.....	17
III PJESA PËRMBYLLËSE.....	19
Konkluzione & Rekomandime.....	19
Objektivat e arritura & Rezultatet	19
Kufizimet.....	20
Propozim ndryshim & Rekomandimet për vitin 2025.....	20
Planet prioritare të Komitetit Konsultativ PAK për vitin 2025.....	21

SHKURTESAT

UA- Udhëzim Administrativ

KKPAK- Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuar

PAK- Persona me Aftësi të Kufizuara

AK- Aftësi e Kufizuar

OJQ- Organizata jo Qeveritare

DKA- Drejtoria Komunale e Arsimit

(I)

PJESA HYRËSE

PARATHËNIE

Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Drenasit, publikon këtë raport vjetor, me qëllim që të mbajmë të informuar të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit lidhur me punën, aktivitetet e realizuara dhe mbledhjet e mbajtura gjatë vitit 2024.

Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara është formuar në muajin janar 2024, me përbërje prej shtatë anëtarëve. Ky komitet në përbërje prej këtyre anëtarëve, është përzgjedhur sipas konkursit nga Komisioni për shqyrtimin e konkursve të Kuvendit Komunal të Drenasit dhe organizon mbledhje formale dhe jo formale përmes të cilave priorizon aktivitete për PAK-un.

Ky organ drejtues institucional i formuar për herë të dytë në Komunën e Drenasit, i cili vepron në harmoni me “Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr.05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e përhershme të komitetëve tjera në Komuna”.

Përmes mbledhjeve të realizuara, anëtarët e Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara kanë shqyrtuar dhe diskutuar në hollësi detyrat dhe përgjegjësitë e veta dhe kanë vënë disa prioritete. Specifikisht si qëllim prioritar të këtij komiteti është të sigurojë përmirësim të dukshëm në statusin dhe cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara, duke nxitur dhe siguruar mundësinë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara në territorin e Komunës së Drenasit t'i gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, kjo gjithnjë në bashkëpunim të përherëshëm me vet këta persona dhe institucionet komunale, me

OJQ-të, që ofrojnë shërbime psiko-sociale, e veçmas me OJQ-të, që ofrojnë shërbime me përfshirje të personave me aftësi të kufizuara.

Për t'i arritur objektivat e synuara, Komiteti Konsultativ PAK fillimisht ka hartuar Planin e Punës dhe kalendarin për takime për vitin 2024, në bazë të cilave ka realizuar aktivitetet.

Ky komitet ka identifikuar një sërë nevojash për ndryshim në të mirën e PAK-ut. Nevojat për këto ndryshime është identifikuar përmes takimeve me vet PAK-un dhe familjarë të tyre, me zyrtarë të drejtorive komunale, përfaqësues të OJQ-ve dhe aktivitete të tjera, rezultatet e nxjerrura janë ngritur në formë të rekomandimeve (propozimeve për ndryshim) dhe janë diskutuar me digaster të ndryshëm.

Plani vjetor i punës së Komitetit Konsultativ për PAK për vitin 2024

Aktiviteti	Objektivat	Periudha Kohore	Rezultati	Përgjegjës
Takimet e rregullta mujore të KKPAK-së	Prezantimi i punës mujore të KKPAK-se	Janar- dhjetor 2024	KKPAK-së funksionale	Antarët e KKPAK-së
Përgatitja e Planit të aktiviteve sipas identifikimit të nevojave nga antarët e KKPAK-së	Shkëmbimi dhe prezantimi i ideve të antarëve të KKPAK-se sipas nevojave të identifikuar dhe adresimi i tyre në organet përkatese 1. Mbeshtetje në ofrimin e shërbimeve rehabilituese për persona me aftësi të kufizuara (thirrja për grande-projekt propozime për OJQ-të nga DSHMS). 2. Mbeshtetje e PAK-vë, në fushën e arsimit (takime me ekipin	Janar- dhjetor 2024	Përgatitja e përkrahjes së PAK-ve në bazë të problematikave të identifikuar nga antarët e KKPAK-së	Antarët e KKPAK-se

	<p>vlërësues, avokim të DKA per asistent për fëmijë me AK.)</p> <p>3. Mbështetje e PAK-vë në fushën sociale (implementimi i skemes pensionale për PAK.</p> <p>4. Mbështetje e PAK në fushën e kulturës rinisë dhe sportit (mbeshtetje nga DKRS për PAK në aktivitete kulturoresportive).</p> <p>5. Qasja fizike infrastruktura (qasja në rrugë, qasja në shkolla, sinjalizimi akustik, qasje në qytet për persona të verbër)</p> <p>6. Punësimi dhe aftësimi i PAK-ve(fuqizimi i inspektoratit të punës për monitorimin e zbatimit të Ligjit Nr.03/019 për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim, Ndërmjetësimi i PAK në punësim)</p> <p>7. Te drejtat e PAK-ve (takime me Drejtorit Komunale me perfaqesues të OJQ-ve për të drejtat e PAK-ve).</p>			
--	--	--	--	--

Hartimi i Raportit për punën e KKPAK-së gjatë vitit 2024	Analiza e Punës së KKPAK-së për punën gjatë vitit 2024	Dhjetor	Hartimi i Raportit për punën e KKPAK-së gjatë vitit 2024	Kryesuesja e KKPAK-së
Vlerësimi i punës së KKPAK-së	Vlerësimi i punës nga anëtarët e KKPAK-së dhe diskutime për të ardhmen e këtij komiteti	Dhjetor	Përgatitja e Aktiviteteve për vitin e ardhshëm	Anëtarët e KKPAK-së
Raportim në Kuvendin Komunal për aktivitetet e KKPAK-së	Informim i Kuvendit mbi aktivitetet e KKPAK-së	Janar- dhjetor 2024	Zbatimi i udhëzimit të KKPAK-së dhe informimi i Kuvendit për punën e KKPAK-së	Kryesuesja e KKPAK-së

(II)

PJESA TEMATIKE**MBLEDHJET****MBLEDHJET E REALIZUARA & AKTIVITETE TË RËNDËSISHME**

Sipas rregullativës së Kuvendit Komunal të Drenasit, Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara ka mbajtur gjashtë (6) mbledhje të rregullta, por jo vetëm përveç mbledhjeve të rregullta, ky komitet ka mbajtur rreth 5 takime të tjera konsultative dhe vizita në terren përmes të cilave janë konkretizuar ide dhe specifika në aspektin e përmirësimit të jetës së personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Drenasit. Mbledhjet formale zakonisht ky komitet i mbanë në zyrën e Kuvendit Komunal të Komunës së Drenasit ose në sallën e Komunës, kurse mbledhjet jo

formale dhe takimet tjera konsultative i zhvillon në terren dhe sipas rastit. Ftesa për mbledhje u është dërguar anëtarëve dhe të ftuarve 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes.

Mbledhjet në vazhdim paraqesin të dhëna lidhur me:

- Datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes;
- Të ftuarit;
- Pikat e rendit të ditës;
- Konkludimet e nxjerra në secilën mbledhje.

Mbledhja e parë e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara

Procesverbal

Më 26.01.2024 (e mërkurë), Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara ka mbajtur mbledhjen e parë të rregullt, në sallën e Kuvendit Komunal të Drenasit.

Mbledhja e Komitetit Konsultativ PAK, filloi në orën 10:00 dhe procesverbali është mbajtur nga njëra nga anëtarët e zgjedhura të këtij komiteti Indire Ollur-Thaçi.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin shtatë anëtarët e zgjedhur të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK): Lendita Elshani, Leonora Shala, Deshira Berisha-Morina, Antigona Bucolli, Mirlindë Gashi-Xhylani, Indire Olluri-Thaçi dhe Altesa Bytyqi.

Pasi u konstatua se në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët u propozua rendi i ditës.

Rendi i ditës ishte:

1. Zhgjedhja e Kryesuesit të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara;
2. Zgjedhja e zëvendëskryesuesit të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara;
3. Të ndryshme.

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës, kemi diskutuar për zgjedhjen e kryesuesit të këtij komiteti.

Njëri nga anëtarët e këtij komiteti, përkatësisht Lendita Elshani, ka propozuar për kryesuese Antigona Bucollin, e cila unanimisht është zgjedhur si kryesuese me votat e të gjithë anëtarëve të tjerë.

Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, Leonora Shala ka propozuar që zëvendëskryesues të zgjedhet Indire Olliri -Thaçi e cila poashtu është zgjedhur unanimisht me votat e të gjithë anëtarëve. Pas votimit të këtyre dy propozimeve është kaluar në pikën e radhës.

Në pikën e tretë të rendit të ditës, u diskutua për planifikimin e aktiviteteve në kuadër të detyrave dhe obligimeve si komitet konsultativ për PAK-un, për Komunën e Drenasit.

Mbledhja përfundoi në ora 10:20.

Mbledhja e dytë e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara

Procesverbali

Më 14.02.2024 (e mërkure), Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, ka mbajtur mbledhjen e dytë të rregullt, në sallën e Kuvendit Komunal të Drenasit.

Mbledhja filloi në ora 10:00, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e KKPAK-së, përkatësisht: Lendita Elshani, Leonora Shala, Deshira Berisha-Morina, Antigona Bucolli, Mirlindë Gashi-Xhylani, Indira Olluri-Thaçi dhe Altesa Bytyqi.

Rendi i ditës ishte:

1. Procesverbali i mbledhjes së dt.26.01.2024;
2. Hartimi i Planit të Punës;
3. Të ndryshme.

Bazuar në rendin e ditës është aprovuar pika e parë e rendit të ditës.

Pasataj për diskutim kemi kaluar të pika e dytë ku jemi dakorduar dhe koordinuar se, para se të hartohet plani të bëhen disa vizita të drejtpërdrejta me persona me aftësi të kufizuara siç janë: OJQ-të, që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, si Hendikos në Drenas, Shoqata e të Shurdhëve etj.

Sa i përket pikës së tretë kemi diskutuar që të bëhen takime të shpeshta, jo vetëm të mbledhjeve të thirrura nga kryesuesja.

Kryesuesja e komitetit me pajtimin e të gjithë anëtarëve caktoj takimin në Hendikos më, 21.02.2024.

Mbledhja përfundoi në ora 11:15 nga procesmbajtësja Indira Olluri- Thaçi.



Mbledhja e tretë e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara

Procesverbali

Më 15.05.2024 (e mërkure), Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara ka mbajtur mbledhjen e tretë të rregullt, në zyrën për takime të Kryetarit të Komunës së Drenasit në ora 08:10.

Mbledhjen e kryesoi Antigona Bucolli- kryesuese.

Kryesuesja deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Personat me Aftësi të Kufizuara, ku të pranishëm ishin anëtarët e zgjedhur të Komitetit Konsultativ (KPAK): Antigona Bucolli, Lendita Elshani, Deshira Berisha-Morina, Mirlindë Gashi-Xhylani, ndërsa munguan Indire Olluri -Thaçi dhe Altesa Bytyqi.

Të pranishëm ishin Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Skender Berisha, Bekim Dobra dhe drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Lumnije Krapit. Pasi u konstatua se në mbledhje janë të pranishëm anëtarët e komitetit u propozua rendi i ditës.

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së dt.14.02.2024;

2. Hartimi i Planit të Punës;

3. Të ndryshme.

1. Aprovohet pika e parë e rendit të ditës procesverbali i mbledhjes së kaluar më 14.02.2024.

2. Hartimi i planit të punës Lendita Elshani prezantoi planin e punës të KKPAK-ut për vitin 2024, ku në mënyrë të detajuar i shtjelloi të gjitha sfidat dhe nevojat me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Drenasit. Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci e mirëpriti dhe u zotua se do ta përkrahe këtë kategori po sa t'i jepet mundësia, ku edhe na informoi që gjatë muajit qershor Komuna do të hapë shpalljen për grante për aplikim për projekt në fushën e shërbimeve sociale.

3. Të ndryshme.

Kryesuesja e komitetit njoftoi se, për arsye personale anëtarja Leonora Shala ka dhënë dorëheqje nga ky komitet.

Mbledhja përfundoi në ora 09.00.



Mbledhja e katër e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara

Procesverbali

Më 11.07.2024 (e enjte), Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara ka mbajtur mbledhjen e katër të rregullt në sallën e bordit të Komunës së Drenasit.

Mbledhjen e kryesoi Antigona Bucoll, kryesuese e cila deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, ku të pranishëm ishin anëtarët e zgjedhur: Antigona Bucolli, Lendita Elshani, Deshira Berisha-Morina dhe Indira Olluri Thaçi, ndërsa munguan Mirlinda Gashi-Xhylani dhe Altesa Bytyqi.

I pranishëm gjatë takimit ishte psikologu i Komunës Hazir Elshani nga DKA-ja.

Rendi i ditës ishte:

1. Procesverbali i mbledhjes së dt.20.05.2024;
2. Krijimi i kushteve për gjithpërfshirjen në arsimin parafillor;
3. Të ndryshme.

Aprovohet pika e parë e rendit të ditës, procesverbal i mbledhjes së kaluar 20.05.2024.


Krijimi i kushteve për gjithpërfshirjen në arsimin parafillor dhe fillor, mbështetja profesionale të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Komunën e Drenasit.

Hazir Elshani, theksoi se Komuna e Drenasit është më e mira në vlerësim të fëmijëve me nevoja të veçanta. Për shkak se jemi në fazën fillestare në fazën e nismës, faza e parë e kërkesës për vlerësim të fëmijëve me nevoja të veçanta, kjo do të thotë që kemi arritur shumë. Nëse një fëmijë lind dhe identifikohet se ka nevojë për një ndërhyrje për një qasje në zhvillimin e hershëm, ne kemi arritur që ta përkufizojmë këtë stad të zhvillimit të këtij vlersimi.

Z. Haziri poashtu theksoi se është i gatshëm për bashkëpunim me ne, na njoftoi që fëmijët janë duke u vlerësuar. Ekipi vlerësues është funksional në pritje për vlerësim në Komunën e Drenasit janë tre fëmijë. Deri me tani janë 7 asistent për fëmijët me nevoja të veçanta nëpër shkolla të Komunës së Drenasit.

Ne antarët e Komiteti Konsultative të Personave me Aftësi të Kufizuara pasi që e kemi pa në buxhet të Komunës të vitit të ardhshëm, që në disa shkolla do të ndërtohen lodra për fëmijë në oborret e shkollave. Kërkuam që ndër to të ndërtohen edhe lodrat për personat me aftësi të kufizuara, kërkuam që të ketë edhe më shumë asistent për fëmijët me nevoja të veçanta, kemi kërkuar që të rregullohet edhe puna e transportit pasi që edhe me ligj u takon.

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesja e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 15:00.



Mbledhja e pestë e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara

Procesverbal

Më 15.10.2024 (e marte), Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, ka mbajtur mbledhjen e pestë të rregullt, në sallën e Kuvendit Komunal të Drenasit.

Mbledhjen e kryesoi: Indira Olluri Thaçi, zëvendëskryesuese.

Zëvendëskryesuesja deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Personat me Aftësi të Kufizuara, ku të pranishëm ishin anëtarët e zgjedhur të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (KPAK): Indira Olluri-Thaçi, Lendita Elshani, Deshira Berisha-Morina, Mirlinda Gashi-Xhylani, munguan Antigona Bucolli dhe Altesa Bytyqi.

Të pranishëm gjatë takimit ishin Vlora Gjinovci nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Edonë Tahiraj nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinorë.

Pasi u konstatua se në mbledhje janë të pranishëm anëtarët e komitetit u propozua rendi i ditës.

Rendi ditës ishte:

1. Procesverbal i mbledhjes së dt. 11.07.2024.
2. Problematikat e qasjes së personave me aftësi të kufizuara, dhe sfidat e zbatimit të Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ 33/2007, për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuar.
3. Të ndryshme.

Aprovohet pika e parë e rendit të ditës procesverbal i mbledhjes së kaluar i dt. 11.07.2024.

Problematikat e qasjes së personave me aftësi të kufizuara, dhe sfidat e zbatimit të Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuar.

Ne si komitet i paraqitem problematikat me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara në Komunën tonë, ku theksuam se trotuaret nuk janë në nivelin e duhur për të kaluar rrugën, përveç që janë të rregulluar me përmasa të larta, dhe në mes të tyre ka edhe shtylla elektrike të vendosura. Po ashtu se qasja në bar-restaurante nuk është në nivelin e duhur në disa nuk ka as pjerrina, në disa ka por nuk janë me standarde, si dhe marrja e ndonjë shërbimi në banka është i pamundur për arsyea se disa janë vetëm me shkallë, disa me pjerrina por pa standarde, sikur edhe qasja në postë etj.

Vlora Gjinoftci, shefe e Drejtorisë së Infrastrukturës theksoi se sheshi të cili është duke u rregulluar tashmë i ka përfunduar të gjitha procedurat për leje të ndërtimit, dhe e kanë shqyrtuar këtë ligj dhe sheshi është duke u ndërtuar mbi bazën e këtij ligji.

Ju shtrua pyetja se në projekt a ka ndonjë stade për ecje me shkop për persona të verbër?

Vlora Gjinoftci- tha jo nuk ka, dhe kjo gjë për persona të verbër është e vështirë, sepse ja mohon lëvizjen e lirë, dhe nuk ka mundësi për një ndryshim në këtë projekt.

Po ashtu nga ne u cek që edhe ndërtimet që po bëhen tashmë në komunën tonë, lejet për ndërtim kur lëshohen, a bëhen sipas ligjit për personat me aftësi të kufizuara?

Edonë Tahiraj, tha se çdo leje ndërtimi që lëshohet nga kjo drejtori jepet në baza ligjore, ku shikohen të gjitha sikur se qasja, lifti etj.

Në kërkim që Drejtoria e Inspeksionit t'i shikoj sa më shumë këto ndërtime që janë duke u bërë të jenë në mënyrë të duhur dhe sa më shumë në interes të personave me aftësi të kufizuara.

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesja e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 14:00.



Mbledhja e gjashtë e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara

Procesverbali

Më 25.11.2024 (e enjte) Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, ka mbajtur mbledhjen e gjashtë të rregullt, në sallën e bordit të Komunës së Drenasit.

Procesverbali

I mbledhjes së Komitetit për Personat me Aftësi të Kufizuara, mbajtur më 25.11.2024, duke filluar në ora 13.00.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e zgjedhur të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (KPAK): Antigona Bucolli, Indira Olluri-Thaçi, Deshira Berisha-Morina, Mirlinda Gashi-Xhylani.

Mungoi: Lendita Elshani dhe Altesa Bytyqi.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Përfaqësuesi i Handikosit Bexhet Binaku, përfaqësuesi nga Shoqata e të Verbërve Emin Cakiqi, Zahrie Podrimqaku-Subashi nga Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjiniore dhe Arlinda Kukaj nga Drejtoria e Shëndetësisë. Kryesuesja, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e komitetit Antigona Bucolli, me këtë

Rend të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes më 15.10.2024;
2. Prezantimi i nevojave dhe sfidat e organizatave që përfaqësojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Drenasit;
3. Të ndryshme.

Aprovohet pika e parë e rendit të ditës procesverbali i mbledhjes së kaluar më 15.10.2024.

Prezantimi i nevojave dhe sfidat e organizatave që përfaqësojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Drenasit. Arlinda Kukaj, çdo vit i subvencionojmë me miell e gjëra të tjera, për vitin 2025 nuk kemi paraparë ende asgjë.

Behxhet Binaku, nga komitetit për personat me aftësi të kufizuara, është mekanizëm urë lidhëse mes komitetit dhe Komunës, një organ që i adreson problemet e jo vendimmarrës. Ai theksoi se kemi marrë një projekt nga UNICEF, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, ne si OJQ, jemi të pakënaqur me të gjitha digasteret si nëpër shkolla dhe në ndërtimin e sheshit. Në Shoqatën e të shurdhërve i kemi diku afër 40 persona. Emin Cakiqi për Drejtorinë e Shëndetësisë kam një ankesë sepse po na detyrojnë të paguajmë për shërbime shëndetësore, gjithashtu kërkoi të kemi edhe një zyre për Shoqatën e të verbërve.



(III)

PJESA PËRMBYLLËSE

Konkluzione & Rekomandime

Komiteti duke parë rëndësinë e bashkëpunimit dhe nxitjen e tij në realizmin e objektivave të veta, ka siguruar bashkëpunim institucional për PAK-un, nëpërmjet shkëmbimit dhe ndarjes së informacionit dhe praktikës më të mirë. Ky raport është një sinjal i qartë se mbi bazën e aktiviteteve tona, kemi hipotetizuar e ngritur objektiva konkrete, kemi aranzhuar takime e vizita në terren me akter të ndryshëm, kemi identifikuar problematika kemi parë nevojën për ndryshim dhe arritur rezultate konkrete. Andaj, sipas kësaj logjike kemi ardhur në përfundim mbi nevojën e ngritjes së disa rekomandimeve praktike, të cilat i kontribuojnë nevojës për ndryshime.

Objektivat e arritura & Rezultatet

- Në aspektin e përgjithshëm kemi arritur që në përpikmëri t'i përmbahemi Udhëzimit Administrativ, në harmoni me të cilin veprimet lidhur me realizmin e punës dhe aktiviteteve tona. Kjo gjithmonë duke e mbajtur të informuar zyrën e Kuvendit Komunal me procesverbalet e

mbledhjeve, raportet tre mujore si dhe në takimet e realizuara me kryesuesin e Kuvendit Komunal.

- Gjithashtu objektivë kryesore ka qenë t'i përmbahemi me përpikmëri Planit të Punës, për vitin 2024 dhe nga aktivitetet e realizuara, rezulton se pothuajse të gjitha janë arritur në kohën e planifikuar, madje janë arritur rezultate edhe përtej pritjeve tona.
- Kemi lidhur bashkëpunim të ngushtë me HANDIKOS-in, në Drenas, dhe me anë të partneritetit të krijuar kemi identifikuar aktivitetet që realizon kjo OJQ, çfarë është sfidë për ta, dhe çfarë është e nevojshme që ata të vazhdojnë të kontribuojnë për PAK.
- Kemi marr informacione mbi gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin parafillor dhe fillor, mbështetja profesionale nga koordinatori për gjithëpërfshirje në Komunën e Drenasit z.Hazir Elshani.
- Ngushtësisht jemi në kontakte të vazhdueshme me drejtorë dhe mësimdhënës shkollash të komunës së Drenasit, të cilët ofrojnë shërbimet e nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Problematikat e çasjes së personave me aftësi të kufizuara, dhe sfidat e zbatimit të Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për çasjen e personave me aftësi të kufizuar është adresuar të digaserët përkatëse.

Kufizimet

- Një nga kufizimet e aktiviteteve tona gjatë këtij viti, është se nuk kemi realizuar vizitat informuese nëpër të gjitha shkollat e Komunës së Drenasit, kemi qenë vetëm dy nga to, për të parë nga afër se si po zhvillohet arsimi gjithëpërfshirës.
- Mos realizimi i takimeve me më shumë drejtorë dhe zyrtarë të institucioneve komunale, si p.sh. takime me Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport, në mënyrë që të nxirren rekomandime të përbashkëta për të shiquar mundësitë për PAK-un, për aktivitet creative për zhvillimin e ndonjë loje nga PAK-u kjo si pasoj e gjendjes jo të mirë shëndetsore në të njëjtë periudhë kohore të anëtarëve të KKPAK.

Propozime për ndryshim & Rekomandimet për vitin 2025

- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me institucionet publike private si dhe me OJQ-të, që të ofrojnë shërbime cilësore për PAK-un, sipas ligjeve në fuqi.
- Inkurajojmë institucionet komunale që të njohin dhe zbatojnë të drejtën e personave me nevoja të veçanta për të punuar, njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë duke marrë hapat e duhur përfshirë masat ligjore.
- Rekomandojmë DKA-në, për angazhmin e psikologëve në të gjitha shkollat, kjo ngase siç e dimë roli i tyre është i domosdoshëm për një arsim gjithpërfshirës.
- Përpjekje në gjetjen e mënyrave për të ndikuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe rregullimit të pjerrinave në ato hapësira ku PAK-u, kanë qasje dhe detyrimisht duhet të marrin shërbimet e nevojshme.
- Takime të rregullta me kryetarin e Komunës së Drenasit, si dhe me përfaqësues të tjerë nga Kuvendi Komunal, për të shkëmbyer ide dhe përvoja në këtë fushë.

Planet prioritare të Komitetit Konsultativ për PAK për vitin 2025

Planet prioritare të KKPAK-ut, për vitin 2025, pjesërisht përfshijnë aktivitetet produktive të filluara në vitin gjatë këtij viti si monitorimi i implementimit të legjislacionit për PAK, hulumtim rreth arsimit gjithpërfshirës, rregullim i infrastrukturës për PAK, shërbime shëndetësore cilësore si dhe mundësi punësimi për PAK në institucione publike dhe private.

Ky raport është shqyrtuar dhe miratuar nga anëtarët e Komitetit Konsultativ për PAK-un,

Anëtarët e Komitetit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Drenas:

1. Antigona Bucolli kryesuese,
2. Indire Olluri-Thaçi zëvendëskryesuese,
3. Lendita Elshani anëtare,
4. Deshira Berisha-Morina anëtare,
5. Mirlindë Gashi-Xhylani anëtare.



Kryesuesja e Komitetit

Antigona Bucolli